



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština –Municipality of Prishtina**



---

## **EKSTRAKTI I PROCESVERBALIT**

**të mbledhjes së njëmbëdhjetë të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, mbajtur më 30.9.2013, e cila filloi në orën 10:00.**

**Në mbledhje morën pjesë:** prof. dr. Isa Mustafa, kryetar i Komunës, dr. Avdullah Hoti, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, kryesues i Kuvendit, këshilltarët: Hazir Borovci, Shaip Hajrizi, Bekim Gashi, Ismail Kasumi, Musli Mehaj, Fetah Salihu, Hetem Kupina, Avdush Dobratiqi, Vjollca Dibra - Ibrahim, Rrahman Ismajli, Sarandë Sadriu, Rexhep Mustafa, Valon Hiseni, Premtina Rakovica, Muhamet Nura, Vjollca Rizani, Ajnishahe Azemi, Mustafë Krasniqi, Arta Krasniqi, Luan Jusufi, Sali Krasniqi, Tefik Mehmeti, Shefki Gashi, Naime Osmani, Bajram Selimaj, Shefqet Sylejmani, Agim Krasniqi, Flamur Shala, Nexhmije Berisha, Aziz Pacolli, Milazim Vitia, Naim Makolli, Donika Surdulli, Nerxhivane Vitia, Sofije Kllokoqi, Shemsi Veseli, Skënder Reçica, Liridon Restelica, Besa Halimi - Zagragja, Lumnie Rama, Meliza Haradinaj, Mejreme Berisha, Astrit Hasani, Besa Rafuna, Kimet Zeqa, Feti Mehdiu dhe Sadri Ramabaja.

**Munguan:** Remzi Pacolli dhe Aferdita Veliu.

**Morën pjesë** përfaqësues të Ministrisë së Pushtetit Lokal, përfaqësuesit e OJQ-ve, përfaqësuesit e medieve dhe përfaqësuesit e kompanive që do të bënë prezantimin e Planit zhvillimor urban.

**Mbledhjen e kryesoi dhe e udhëhoqi Sami Hamiti,** kryesues i Kuvendit.

**Kryesuesi** tha se për shkaqe teknike, transkripti dhe ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar nuk ka mundur të dërgohet me kohë me materialet e tjera, andaj propozoi që të futen në rend dite për këtë mbledhje.

**Me shumicë absolute votash, një kundër (Sadri Ramabaja), u miratua ky**

## **R E N D D I T E :**

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
- 2. Propozimplani rregullues urban “Prishtina e Re - Lindje”;**
- 3. Propozimplani rregullues urban “Prishtina e Re - Qendër”;**
- 4. Propozimplani rregullues urban “Prishtina e Re - Perëndim”;**

5. Propozimvendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014 dhe kornizës afatmesme buxhetore 2014 - 2016;
6. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Stacionit policor "Jugu" në Prishtinë;
7. Informatë për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të Komunës së Prishtinës, për vitin shkollor 2012/2013;
8. Pyetje dhe përgjigje;
9. Të ndryshme.

## Pika e parë

### Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dhjetë.

**Sadri Ramabaja** bëri vërejtje në ekstrakt, duke thënë se mendimi i tij, mesazhi që kishte dashur ta përcjellë ishte përmbledhur pak a shumë në gjashtë fjali, këtu në ekstrakt është sjellë në dy fjali, andaj dhe nuk dihet se çka është dashur të thuhet etj.

**Me vërejtjen e dhënë, njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.**

## Pika e dytë

**Lidhur me propozimplaniet rregulluese urban "Prishtina e Re: "Lindje", "Qendër" dhe "Perëndim", rreth rrjedhjes së procedurave për hartimin e këtyre planeve, në pika të shkurtra informoi Behxhet Musliu, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit.**

**Bujar Demjaha**, përfaqësues nga kompania projektuese, bëri një prezantimin të shkurtër të këtij Propozimplanit rregullues urban "Prishtina e Re - Lindje" në mënyrë elektronike, duke elaboruar vetëm ndryshimet që janë bërë në bazë të vërejtjeve, e që nga Komisioni janë marrë si vërejtje të arsyeshme.

Pas prezantimit të planit, **kryesuesi** hapi diskutimin.

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi shqyrtuar dhe analizuar këtë propozimplan rregullues urban "Prishtina e Re - Lindje", dhe kemi vërejtur se pas të gjitha takimeve punuese që janë bërë rreth këtij plani dhe të gjitha vërejtjeve që janë dhënë, qoftë nga qytetarët, nga grupet e interesit, nga drejtorja, apo nga ne këtu, që e kemi dhënë kontributin tonë, në masë të madhe janë marrë parasysh dhe janë inkorporuar. Ne vlerësojmë se është bërë një punë mjaftë nga ana e kompanisë dhe kompanive të tjera në planet tjera rregulluese, rreth hartimit të tyre, prandaj e përkrahim dhe do ta votojmë për miratim.

**Aziz Pacolli** në emër të GP të AKR-së, përshëndeti punën e bërë nga ana e këtyre kompanive, gjithashtu edhe punën e Kuvendit, që vërtetë një projekt që e qon në diskutim publik të jetë e njëjta legjislaturë e cila dhe e përfundon. Vërejtjet të cilat janë dhënë më herët janë inkorporuar, andaj si GP edhe ne e përkrahim këtë plan për miratim.

**Lumnije Rama**, në emër të GP të PDK-së, e përkrahu miratimin e këtij plani.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe ne e përkrahim miratimin e këtij plani.

**Kimete Zeqa**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne vlerësojmë punën e kompanisë, të cilët disa herë u janë drejtuar këshilltarëve, kanë bërë një punë mjaftë të mirë dhe për atë do ta përkrahim këtë plan.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se dua ta potencojë një fakt. Pavarësisht se jemi plotësisht për miratimin e planeve që rregullojnë çështjen e ndërtimit të qytetit, zgjerimit të tij etj. megjithatë do ta shpreh vërejtjen tonë, që ka të bëjë me kërkesat vend e pa vend të pronarëve të parcelave dhe të grupeve të interesit.

Prezantimi na verifikoi se në këtë mënyrë praktikisht qyteti dëmtohet, etazhet po rriten edhe aty ku nuk do të duhej të rriteshin, ndërkaq hapësira e gjelbër po zvogëlohet në dobi të mafisë së ndërtimit dhe një pjese të pronarëve, sidomos në disa zona që i kemi studiuar mirë, nuk kanë qenë pronarë më herët, por tash njihen si pronarë. Se si janë bërë pronarë, është çështje e tyre, por po dëmtohet prona, perspektiva e mirë e ndritur që do të mund të bëhej edhe në ato zona të veçanta.

E kam fjalën për zonën e Matit, Prishtinën lindore etj etj. Megjithatë kemi vërejtje shumë serioze dhe mendojmë që t'i korrigojmë kur të kemi mundësi, sidomos në këto pjesë ku dëmtohet shumë interesi publik.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, u shpreh se ky plan do të jetë lehtë i zbatueshëm, pasi që është një zonë pa ndërtime ilegale dhe planifikimi do të mund të gjej zbatim sipas të gjitha standardeve të përcaktuara. E përgëzoj kompaninë për punën e bërë.

**Njëzëri u miratua vendimi për Planin rregullues urban "Prishtina e Re - Lindje".**

**Pika e tretë**

**Lidhur me Propozimplanin rregullues urban "Prishtina e Re - Qendër", Driton Lleshi**, përfaqësues nga kompania projektuese, në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij plani, duke elaboruar vetëm për disa ndryshime rreth destinimit të sipërfaqeve të ndryshme qenësore.

**Kryesuesi** hapi diskutimin.

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, tha se këto kompani që kanë hartuar këto plane kanë bërë punë të mirë, por edhe është bërë një harmonizim i të tri planeve rregulluese, të cilët janë ngjitur njëri me tjetrin. Në masë të madhe janë marrë edhe vërejtjet dhe sugjerimet që janë dhënë, po ashtu edhe pas debatit publik që janë dhënë nga grupi i ekspertëve. E çmoj punën që kanë bërë dhe ne e përkrahim dhe do ta votojmë për miratim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, kërkoi që gjelbërimi, i cili u përmend nga prezantuesi, të jetë në sipërfaqe aq sa është edhe i planifikuar, dhe kërkoi sqarim për trenin urban, se ende nuk po e di ku po nisët dhe ku po përfundon.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se ne jemi pak të sfiduar, sepse ndoshta ishte dashur që për të tri planet përnjëherë të flasim, por, sido-kudo, unë e përshëndes punën e hartuesve, megjithatë nuk mund të them se është e përkryer, e di që ka të meta. Çështja është se bazuar në ligjin, duhet të përshkruhet analiza e situatës urbane, të diskutohet për planin dhe për bazën strategjike të implementimit. Ka shumë gjëra që nuk janë përshkruar, siç është analiza e kostos etj. etj.

Jam i vetëdijshëm se është vështirë që 100% të harmonizohet me Planin zhvillimor urban, për arsye se janë vijat ndërtimore dhe gjërat që i kamë vërejtur janë të pakta, por, megjithatë, duke e marrë parasysh që shumica janë implementuar, harmonizuar, atëherë ne si GP do ta përkrahim për miratim.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe ne si GP këtë plan e përkrahim për miratim.

**Feti Mehdiu**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne do ta përkrahim, me një sugjerim që t'i përmbahen sa më shumë ruajtjes së hapësirës së gjelbër, mos të rrezikojnë në llogari të ndërtimit, sepse do të ketë aty presione, por ta ruajnë atë, sepse zona e gjelbër nuk krijohet herdo-kurdo.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se të zvogëlosh zonën e gjelbëruar nga 40 m në 25 m, me arsyetime të tilla se po bëhet bulevard etj. etj. praktikisht nuk është në të mirën e publikut. Pra, ne po e dëmtojmë ambientin tonë. Lidhur me çështjen rreth zonës së gjelbëruar, **kryesuesi** dha sqarime të nevojshme.

**Njëzëri u miratua vendimi për Planin rregullues urban "Prishtina e Re - Qendër".**

## **Pika e katërt**

**Lidhur me Propozimplanin rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim", Lulëzim Kabashi**, përfaqësues nga kompania projektuese, në mënyrë elektronike bëri prezantimin e këtij plani, duke elaboruar vetëm disa ndryshime, kryesisht në infrastrukturën rrugore dhe në hapësirat gjelbëruese.

**Ktyesuesi** hapi diskutimin.

**Mustafë Krasniqi**, në emër të GP të LDK-së, e përgëzojmë kompaninë për punën e mirë që ka bërë. Shumica e vërejtjeve dhe sugjerimeve që janë dhënë, janë marrë parasysh aty ku është dashur të merren parasysh. Si GP këtë plan e përkrahim dhe e votojmë për miratim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, tha se edhe ne këtë plan e përkrahim, por kisha bërë një pyetje. Para se të dërgohej në diskutim publik, zona e gjelbërimit në këtë zonë ka qenë 20%. Këtu tani nga prezantuesi u theksua se është zvogëluar. Atëherë, sa përqind është zvogëluar si zonë e gjelbërimit?

Lidhur me pyetjen e parashtruar nga z. Pacolli, rreth zonës së gjelbëruar, përfaqësuesi i kompanisë dha sqarime të nevojshme.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, fillimisht bëri vërejtje për stafin punues, duke shtuar se ka disa emra që janë me përgatitje profesionale jo adekuate, e që nuk është dashur të figurojnë në këtë plan, andaj mund të themi se kjo është shkelje e

ligjit. Po ashtu është pak shqetësuese mos puna e Komiteti për planifikim, mungojnë të dhëna nga grupi i ekspertëve etj, megjithatë këtë plan e përkrahim për miratim.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP të AAK-së, tha se edhe këtë plan e përkrahim për miratim.

**Kimete Zeqa**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se në versionin final të këtij dokumenti është ndërruar destinimi, nga zona e gjelbër në zonë ndërtimi. Janë shumë parcela ku është ndërruar destinimi dhe qytetarët, konkretisht të BL-së V, kanë bërë petition dhe kanë kërkuar disa takime. Ata e kanë bërë kërkesën me shkrim, por këtyre kurrfarë përgjigje nuk u është dhënë. Pse nuk është projektuar unaza e brendshme në trasenë ekzistuese, kur e kemi parasysh se kjo rrugë, sipas shënimeve të Kadastrit, është 20 m e gjërë dhe ka shumë prona shoqërore përgjatë rrugës dhe kur i kemi parasysh shpenzimet e ndërtimit të urave dhe shpronësimet shumë të shtrenjta? Për të gjitha këto, kërkojmë përgjigje me shkrim.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, kërkoj që në pjesën tekstuale të përcaktohet ku është zona mikse afarizëm edhe banim, që të merret në total në bllok dhe, nëse ka kërkesa, qytetarët që kanë pritur deri sot dhe nuk e kanë kërkesën për afarizëm, të iu mundësohet që ta kenë banim, por të ruhet koeficienti vetëm brenda bllokut. Ne e kemi pas një kërkesë të tillë dhe është mirë që të jetë në pjesën tekstuale.

**Njëzëri u miratua vendimi për Planin rregullues urban "Prishtina e Re - Perëndim".**

## **Pika e pestë**

**Lidhur me Propozimvendimin për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014 dhe Kornizën afatmesme buxhetore 2014 - 2016, në pika të shkurtra të pranishmit i informoi Xhelil Bekteshi, drejtor i Drejtorisë së Financave dhe Pronës.**

**Tefik Mehmeti**, në emër të GP të LDK-së, tha se e kemi analizuar dhe shqyrtuar këtë kornizë afatmesme buxhetore 2014 - 2016 dhe buxhetin për vitin 2014, kornizë kjo e hartuar me standarde më të mira, duke u bazuar në ligjet dhe rregulloret financiare në fuqi. Korniza është e qartë dhe përbën elemente thelbësore të problematikës së buxhetit për këtë periudhë. Ne pajtohemi me ndarjet buxhetore të parapara në të, meqë janë të arsyeshme, të nevojshme dhe të realizueshme, të dala nga kërkesat e qytetarëve të Prishtinës në debat me ta. Nëse marrim si shumë buxhetore ose si grant i përgjithshëm, kemi deklaruar se ky buxhet i paraparë për Komunën e Prishtinës është i pa mjaftueshëm, është i vogël për zhvillimin dhe mbulimin e të gjitha kërkesave të qytetarëve gjithëherë në rritje. Këtë e them duke pasur për bazë trendin e rritjes së numrit të banorëve, të cilën rritje çdo herë e përjetojmë, e shohim, e prekim, pavarësisht deklarimit nga regjistrimi i popullsisë. Në shpërputhje me këtë grantet, në shëndetësi dhe në arsim janë zvogëluar, që është e pa akceptueshme për çdo lloj planifikimi buxhetor në rrethana normale.

Problemet e tjera, sidomos ato për paga në arsim dhe shëndetësi, gjithnjë po ju referohem këtyre dy sektorëve më të dijshtëm, është shumë vështirë të funksionojnë normalisht dhe me cilësi me këtë kufizim buxhetor.

Apelojmë te niveli qendror që të kenë konsideratë për të përkrahur me buxhet stabil për këta sektorë dhe të tjerë në kuadër të komunës në përgjithësi.

Në emër të tij dhe të këshilltarëve, përgëzoi kryetarin, z. Isa Mustafa, për punën e mirë që është duke bërë në këtë mandat, duke pas parasysh këtu edhe hartimin e strategjive dhe projekteve për periudhën e ardhshme. Si GP e përkrahim këtë propozimvendim për miratim.

**Aziz Pacolli**, në emër të GP të AKR-së, shtroi pyetje. Duke e analizuar një periudhë gjashtëvjeçare 2007 - 2013, buxheti është rritur në 63 milion, pra është një rritje mjaft e madhe, mirëpo del dallimi prej 71 mijë eurove prej buxhetit aktual dhe atij të planifikuar. Pse është kjo shumë kaq e vogël e planifikuar për vitin e ardhshëm? Duke e llogaritur nga viti 2007 kur ka qenë 11 milionë e diçka, në 2013 kemi arritur në 63 milion, kurse dallimi për 2014, dallimi në mes planifikimit të buxhetit aktual është vetëm 71 000 €. Kisha kërkuar një arsye pse është kaq i ngushtë ky planifikim.

Si GP e pranojmë këtë buxhet dhe e përkrahim për miratim.

**Shemsi Veseli**, në emër të GP të PDK-së, tha se është dashtë që për buxhetin të jetë një analizë më e thellë sa i përket projekteve dhe shtimit të zhvillimit ekonomik, mirëpo kjo çështje po mungon. Do të duhej që të përcillej edhe propozimbuxheti, dhe me analiza të thukëta në kuptimin e asaj, sidomos te përfundimi i mandatit. Ne mendojmë që te korniza afatmesme buxhetore planifikimi që është bërë, sidomos te të hyrat vetanake, konsideroj se ka mundur të jetë një planifikim më i mirë. Në veçanti kur flas për taksat për leje të ndërtimit, mendoj që ka mundur të jetë një planifikim më i madh, duke e pasur për bazë që jemi në proces të legalizimeve ose çështjeve të tjera që realisht mund të arrihet arkëtim më i madh i mjeteve.

Në anën tjetër, po ashtu sa i përket lejeve për ndërtim, mendoj se ka mjaft kërkesa dhe projekte që presin nga investitorët, të cilët nuk kanë marrë ende leje të ndërtimit, dhe kishin mundur të kontribuojnë në arkëtimin e këtyre mjeteve dhe të rritet kjo pjesë e buxhetit. Sa i përket shfrytëzimit të sipërfaqes publike, më duket një shumë e vogël, që faktikisht është planifikim jo real. Sa i përket taksave për shërbime shëndetësore, mendoj se nuk është planifikim si duhet. Edhe te participimet, donacionet, mendoj që nuk është planifikuar mirë, duke pasur për bazë që ka mundësi që të merren projekte dhe donacione prej shumë donatorëve të tjerë. Megjithatë, me gjithë vërejtjet që mund t'i kemi, mendoj se ka mjaft vend që të jepen edhe kritika konstruktive, të përgjegjshme, që do ta pasuronin këtë projektbuxhet.

Si GP këtë buxhet e përkrahim për miratim.

**Mejreme Berisha**, në emër të GP i AAK-së, tha se në bazë të diskutimeve që u paraqitën nga parafolësit, uroj që komuna jonë sa më shumë të ketë suksese dhe të ketë vërtet një buxhet meritore, edhe pse është kryeqyteti i fshatarësisë më të madhe të Kosovës.

Si GP e përkrahim për miratim.

**Kimet Zeqa**, në emër të GP të Partisë së Drejtësisë, tha se edhe ne do ta përkrahim këtë buxhet, por kam një paqartësi rreth disa shifrave në shëndetësi. Aty ku thuhet: ...material zyrtar, letra, protokoll 70000, shpenzimet e stomatologjisë, material harxhues 70000, karburante për vetura 70000, po më duket të gjitha njësoj, kur dihet se kemi më shumë nevojë për shërim në stomatologji sesa për karburante.

**Sadri Ramabaja**, në emër të Lëvizjes Vetëvendosje (VV), tha se ajo që bie në sy në këtë buxhet, është sidomos pjesa për investime kapitale. Në këtë zë duket se nuk kemi një studim paraprak të prioriteteve që do të duhej t'i kishte Kuvendi këtu sot, sidomos qeverisja.

Te zëri për shpenzime kapitale, kemi 120 milionë të planifikuar. Ky zë ka marr një përqindje të mirë të buxhetit, por nëse vërehet me kujdesin e shtuar, lehtë konstatohet se në shpërndarje nuk janë marrë parasysh interesat imediate të qytetarëve. Te zëri 3-4 , shpenzime kapitale, pajisjet me kabinete, inventar shkollor dhe me libra për biblioteka shkollore, kap një shumë prej 450000 €. Nëse merret para sysh numri i shkollave dhe posaçërisht numri i nxënësve në to, atëherë investimi në këtë sferë është jashtëzakonisht i vogël dhe në shpërputhje me pritjet e armatës së nxënësve dhe punëtorëve të arsimit. Mjetet e planifikuara për në infrastrukturë rrugore dhe për zhvillim rural, janë në shpërputhje të plotë me nevojat e qytetarëve. Këta zëra dhe këto politika herë-herë, siç u vërejt edhe sot, janë të karakterit spekulativ të fushatës, edhe ky buxhet që është në dispozicion nuk menaxhohet si duhet. Ne jemi dëshmitarë se është bërë një bartje bukur e madhe e buxhetit që kemi pasur për këtë vit fushate.

Kjo shpërndarje që na është prezantuar pjesërisht këtu përmes planifikimit tejet jo real, sidomos kur kemi të bëjmë me të hyrat vetanake, dëshmon se kemi të bëjmë me mungesë të përgjegjësisë politike, respektivisht planifikim për zhatje të parasë publike nga grupet e interesit.

Si përfundim, ky buxhet që na vjen dhe na rezulton të jetë në shpërputhje të plotë me interesat e qytetarëve, na bën që të mos ndihemi mirë. Ky konkluzion më detyron të marr vendim të përgjegjshëm, që do të thotë shpreh zërin e arsyes duke votuar kundër.

**Besa Rafuna**, në emër të GP të LDD-së, tha se realisht buxheti për Komunën e Prishtinës prej 63 milionësh, është shumë i vogël për kryeqytet, ajo po dihet, por edhe qëllimet për të mbetur në këtë nivel po dihen. Zvogëlimi i grantit për shëndetësi është shqetësues dhe i pakuptimtë. A do të mundet të funksionojë pa probleme Drejtoria e Shëndetësisë me këtë ulje të grantit që është bërë dhe çfarë mekanizmi do të përdorë Komuna për ta baraspeshuar sadopak këtë zvogëlim të grantit, i cili është mjaft i madh.

Ne e përkrahim, por kisha dashur një sqarim lidhur me zvogëlimin e grantit specifik për shëndetësi

**Liridon Restelica** tha se është dashtë që Drejtoria e Financave dhe e Pronës të sjellë një informatë të shpenzimeve, të paktën të tetë mujorit të parë, dhe bashkërisht të ballafaqohemi me të hyrat dhe shpenzimet që i ka pasur.

Për buxhetin e vitit 2014, shihet se është një planifikim jo i mirë për të hyrat vetanake.

Po ashtu te participimet dhe donacionet, vërehet se aty nuk ka një menaxhim të mirë dhe efikas. Sa i përket korniza afatmesme të shpenzimeve, me keqardhje e them, por edhe niveli qendror më në fund e ka vlerësuar atë që duhet me bërë, ndëshkimin komunal. Këtu shihet se edhe te granti i përgjithshëm nuk i ka planifikuar të hyrat vetanake, arsyeja është se nuk din me menaxhuar.

**Ajnishahe Azemi** propozoi që të rritet shuma e mjeteve te subvencionet dhe transferet për shërbime sociale te Drejtoria e Shëndetësisë, duke pas parasysh nevojat e këtyre qytetarëve, njëherësh qytetarëve që kanë nevoja të ndryshme sociale. Lidhur me këtë tha se, në emër të personave me nevoja të veçanta, përhëndes Drejtorinë e Shëndetësisë, njëherësh Kuvendin e Komunës së Prishtinës, që ka futur në buxhetin e vitit të ardhshëm ndërtimin e Qendrës së qëndrimit ditor të personave me nevoja të veçanta. Me këtë Komuna po vazhdon të tregojë kujdesin e madh ndaj kësaj kategorie të popullatës dhe kategorive të tjera sociale.

**Naim Makolli** tha se është për t'u përhëndetur puna që ka bë Drejtoria e Financave dhe e Pronës, e cila ka paraparë që në këtë buxhet të parashihet edhe projekti i planifikimit për Planin urbanistik për lagjen "Kodrën e Trimave", për fshatrat: Bërnice, Bërnice e Ulët, Bërnice e Lartë dhe Bardhosh, si dhe projektin për udhëkryqin e rrugës te Sharbanët.

**Me shumicë absolute votash, një kundër ( Sadri Ramabaja), u miratua Vendimi për miratimin e buxhetit të Komunës së Prishtinës për vitin 2014 dhe kornizës afatmesme buxhetore 2014 - 2016.**

#### **Pika e gjashtë**

**Lidhur me Propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Stacionit policor "Jugu" në Prishtinë, në pika të shkurtër të pranishmit i njoftoi Agim Salihu, shef i Zyrës ligjore.**

**Njëzëri u miratua Vendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të Stacionit policor "Jugu" në Prishtinë.**

#### **Pika e shtatë**

**Për Informatë për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të komunës së Prishtinës, për vitin shkollor 2012/2013, rreth vijueshmërisë së nxënësve, suksesit dhe disa çështjeve të tjera që ndërlidhen me mbarëvajtjen e procesit mësimor, të pranishmit i informoi Halim Halimi, drejtor i Drejtorisë së Arsimit.**

**Besa Halimi - Zagragja** tha se GP i PDK- së ka bërë një analizë të të dhënave të detajuara tabelore dhe të raportit me shkrim të informatës së dhënë të arsimit, dhe Drejtoria e Arsimit për këtë vit ka përgatitur dy informata.



Informata e parë përbënte suksesin dhe vijueshmërinë e nxënësve para përfundimit të riprovimeve, kurse e dyta, pas kërkesës së anëtarëve të Komitetit për arsim, përmban edhe të dhëna për orët e realizuara dhe të porealizuara për arsimin parauniversitar në këtë komunë.

Në këtë informatë mesatarja e nxënësve nëpër klasa është dhënë e veçantë në shkollat rurale nga ato të qytetit, ndryshe nga informata e parë, megjithëse edhe kjo informatë kërkon një sqarim tjetër të brendshëm, sepse edhe brenda klasave në viset urbane p.sh. ka dallime të mëdha ekstreme në numër të vogël dhe të madh. Kurse për sjelljen e nxënësve, që është një problematikë e ndjeshme të arsimit kudo në botë, e natyrisht edhe te ne, nuk kemi ndonjë të dhënë as në raportin përshkrues, as në atë tabelor. Lidhur me realizimin e programit mësimor, del se numri i orëve të porealizuara në arsimin e mesëm të lartë është 15624, kurse në atë të ulët 2858. Kjo çështje bëhet edhe më serioze kur në analizë të të dhënave për secilën shkollë, gjejmë një numër shkollash të cilat kanë zero orë të porealizuara.

Në raportin përshkrues mungojnë sqarime edhe për suksesin, në fakt një elaborim për suksesin që është dhënë këtu, për kriterin e butë të vlerësimit dhe për kriterin objektiv ose real në arsimin e mesëm të lartë.

Në mbledhjen e fundit të Komitetit për arsim, ndër të tjera, është diskutuar edhe për vijueshmërinë e nxënësve, në kontekstin e numrit jashtëzakonisht të madh të mungesave të arsyeshme dhe të paarsyeshme. Krahas kësaj, është theksuar edhe dukuria e lëshimit të orëve nga nxënësit për të falur xhumanë, ndonjëherë edhe me kërkim leje nga mësimdhënësit.

Kisha dashur të theksojë edhe disa kërkesa që kanë dalë nga mbledhja e Komitetit për arsim. E para, artikulon problemin e buxhetit të Komunës së Prishtinës në lidhje me numrin e nxënësve të arsimit të mesëm të lartë, të cilët nuk janë banorë të Prishtinës dhe, e dyta, është mungesa e orës së kujdestarisë, që konsiderohet njëri nga faktorët e rëndësishëm në menaxhimin më të mirë të procesit mësimor.

Shtojmë se informata do të duhej të përmbante edhe të dhëna për regjistrimin e një klase, procesin e regjistrimit, pra në klasë të para dhe të dhjeta për vitin që shkoi, dhe për sfidat që e kanë përcjellë këtë proces.

**Sadri Ramabaja** tha se insistimi që kjo çështja e arsimit parauniversitar, respektivisht mungesës së cilësisë, të shqyrtohet kështu jo seriozisht me një informatë, përkundër kërkesave që janë përsëritur disa herë që çështja e arsimit të trajtohet në mënyrë më serioze, respektivisht mungesa e kësaj cilësie, dhe në një masë shqetësuese degradimi i shkollës, të marr përkujdesin më të madh të këtij Kuvendi, për fat të keq, ka hasur në rezistencë dhe sot na vjen sërish vetëm një informatë, për çka natyrisht se nuk ka mundësi të jepet shumë më shumë rrugëzgjdhje etj. e cila kërkohet.

Nëse e lexojmë me vëmendje këtë informatë, shohim se nota mesatare në arsimin fillor rezulton të jetë diku 4.48. Kjo është krejtësisht në shpërputhje me realitetin faktik, do të thotë kriteri është ulur tej mase dhe na dalin nga bankat e gjimnazit nxënësit që nuk kanë lexuar çoftë edhe një libër të vetëm.

Nota mesatare në arsimin e mesëm të lartë thuhet të jetë 3.43, megjithatë edhe këtu nuk ka mbulesë reale, sepse unë jam shumë i bindur, çoftë edhe një komision krejt i dorës së dytë të shkojë dhe të bëjë inspektim, e vlerëson se nuk është vlerësim real. Natyrisht, në këtë krahurë mungesa e nxënësve dhe numri i madh i mungesave, flasin shumë për rënien e vlerave dhe moralit në arsim.

Realizimi i programit len shumë për të dëshiruar, sepse ka orë të tëra që nuk janë mbajtur. Kjo papërgjegjshmëri e institucioneve ka adresë, është e LDK-së në rastin konkret. Ne nuk mund të themi se vetëm kjo drejtori ka dështuar, nuk është papërgjegjshmëria vetëm e juaja, është edhe e nivelit qendror.

**Flamur Shala** tha se për mbarëvajtjen e procesit mësimor, kontributin më të madh në këtë qasje e ka dhënë Kryetari i Komunës, sigurisht me bashkëpunëtorët e tij, kjo është e pamohueshme. Kjo informatë për ne është e saktë, është me shifra të sakta, është shumë mirë e punuar, e përpunuar dhe gjendjen në arsim e kemi këtë që e kemi në bazë të kësaj informate që e shohim për vitin 2012.

Nëse e krahasojmë me sukseset në vitet paraprake, ne shohim se është një rritje ashtu siç e tha drejtori, dhe këtë rritje ne e shohim si pasojë e vetë rritjes së nivelit të zhvillimit të arsimit në përgjithësi në komunën tonë.

Zhvillimin e infrastrukturës e shohim të lidhur shumë me zhvillimin e vet mësimdhënësve, të cilët janë duke e dhënë kontributin e tyre në arsim, pra dhe kjo po shihet në kryeqytetin tonë në vazhdimësi.

Mendojmë se me trendet e zhvillimit të arsimit që i kap sot komuna, do të arrijmë t'i realizojmë të gjitha ato që i kemi planifikuar edhe me planin zhvillimor të arsimit 2013 - 2017. Ne, si Kuvend, duhet t'i japim shtytje kësaj pune që po bëhet në arsim. E dimë se nuk është e përkryer, e dimë që ka edhe mangësi edhe dobësi. Ato dobësi dhe mangësi duhet t'i shohim realisht, në mënyrë që ato t'i shmangim dhe të ecim përpara në proces të zhvillimit të arsimit.

Kjo është informatë e nuk është raport. Mendoj kështu, sepse raporti duhet të jetë i krahasueshëm me të tjerat rritje etj., pra është një informatë që na jep saktë çka është bërë dhe si ka kaluar procesi mësimor, me të gjitha anët e tij, gjatë vitit 2012.

**Ajnishahe Azemi** u shpreh se duke pasur parasysh përmbajtjen e kësaj informate, ne mendojmë se kjo informatë është mjaft përmbajtjesore, është mjaft domethënëse dhe neve na informon saktë, në mënyrë reale, për të gjitha të arriturat dhe punën në procesin arsimor të komunës së Prishtinës.

**Aziz Pacolli** ngriti një shqetësim rreth cilësisë të mësimdhënësit, duke shtuar se asnjë herë nuk na erdhi një informatë, ose pse njëherë nuk vijmë me një përfundim me prurje se çfarë cilësie të mësimdhënësve kemi. Sa i përket informatës, ajo është shkruar mirë, por vërtet të lavdërohet aq tepër në këtë kohë të kompjuterizimit dhe mos të ketë asnjë referat dhe të kalojë nxënësi filloren, të kalojë shkollën e mesme dhe mos të lexojë asnjë libër, edhe mos të merren masa ndaj atij mësimdhënësi, atëherë vërtet arsimit nuk është në nivel. Do të isha shumë i lumtur kur në një seancë do të paraqitej cilësia e mësimdhënësve në kryeqytet ose në shkollat tona në përgjithësi.

**Shefki Gashi** tha se ne nuk jemi ekspertë për ta bërë analizën e punëve në arsim, besoj se edhe Komuna nuk ka ekspertë për me e bërë analizën e nivelit të suksesit që është arritur nëpër shkollat e ciklit të ulët, të mesëm dhe atij të lartë, këto janë përgjegjësi e Ministrisë së Arsimit. Duhet ta analizojmë mirë informatën, të kemi shënime të sakta se a është rritur hapësira e punës brenda me nxënës, a është rritur numri i kabineteve, a janë rritur sallat e edukatës fizike, a janë rregulluar fushat sportive, a janë bërë kushtet tekniko - materiale për punën e pedagogëve në këto shkolla.

Sa i përket mbikëqyrjes së punës së brendshme të pedagogëve, me sa e di unë, nuk është kompetencë e komunës, ajo është kompetencë e Ministrisë së Arsimit, kështu që ne duhet ta marrin përgjegjësinë që na takon.

**Feti Mehdiu** tha se edhe ne e kemi analizuar këtë informatë, si informatë e kemi marrë dhe, pavarësisht nga diskutimet, me shumicën e tyre pajtohem. Unë do të përqendrohem tek ajo që kemi pa ne më herët e që nuk u përmenden këtu.

Unë mendoj se, me disa sugjerime, do t'i përmendi tash më poshtë, besoj që është në frymën e asaj, që thuhet në fillim atje se e ka për detyrë të përcaktojë objektivat dhe detyrat për të ardhmen. Ne mendojmë, këtu te faqja 5, që thuhet "*është rritur suksesi*", ne e kemi një rezervë këtu, dhe pyesim se a është ngritur suksesi, a ka një kriter, sepse ne jemi dëshmitarë se në universitet na vjen duke rënë kriteri, jo rritja e suksesit, prandaj është një punë që duhet të analizohet më mirë.

Po ashtu, kemi edhe një sugjerim, të shohim se çka është bërë me rrethin: nxënës - shkollë - prind - inspektorat dhe si qëndron ky raport. Mendojmë se analiza dhe vënia në vend si duhet e këtij rrethi, do ta përmirësojë dhe ta rrisë cilësinë në arsim, sigurisht do t'i zvogëlojë edhe mungesat. Ka disa shkolla që nuk e kanë humbur asnjë orë, siç është Shkolla e Gjelbër, dhe sugjerimi jonë është se a meritojnë ndonjë mirënjohje, ndonjë falënderim, i cili do të ndikonte edhe tek shkollat tjera. Natyrisht, aty ku ka shumë mungesa, të merret edhe ndonjë masë përmirësuese që t'u tregohet atyre mësimdhënësve.

**Vjollca Dibra** shprehu pajtim të plotë se është e pakrahasueshme gjendja e arsimit sot me gjendjen e viteve të kaluara, por për dobësitë e shfaqura, ne duhet kërkuar fajin aty ku është. Ne si mësimdhënës të fakulteteve, shohim shumë mirë numrin e pranimit të studentëve nëpër fakultete. Pranimi i studentëve bëhet edhe pas skadimit të të gjitha afateve për pranim të studentëve dhe duhet ta kemi parasysh se si pranohen këta studentë, si kalojnë këta studentë dhe, në fund, të njëjtit studentë na konkurrojnë me diploma për vende të punës për t'u pranuar si mësimdhënës në ciklin e ulët. Pra, çështja çalon që nga lart. Shkollat private, për dallim nga ato publike, kanë një trend më të keq. Përkundrazi, shkollat publike janë shumë më në nivel në krahasim me shkollat private, sa i përket cilësisë dhe sa i përket rezultateve. Pastaj, buxheti i njëjtë, e shohim se është i njëjtë si në vitin e kaluar, ndërsa numri i nxënësve në Prishtinë çdo vit shkon duke u rritur. E dimë se migrimet në Prishtinë nga qytetet tjera dhe nga fshatrat janë të shumta, atëherë si mundet një buxhet i njëjtë me atë të vitin paraprak t'i mbulojë të gjitha nevojat që i ka Drejtoria e Arsimit në komunën e Prishtinës. Sa i përket çështjes së inspektimit, ai është në kompetencë

të Ministrisë. Shtimi i numrit të çerdheve është problem, por ne të gjithë jemi dëshmitarë se Ministria e Arsimit ka ndërtuar shkolla edhe çerdhe edhe në vende të tjera ku na kanë mbetur bosh. Kanë mbetur qoftë pa inventar, qoftë pa mësimdhënës, pra nuk është problem vetëm ndërtimi i këtyre objekteve, problem është pastaj punësimi i mësimdhënësve, inventari i tyre, pra përgatitja e tyre që është e nevojshme për një proces zhvillimor. Ne e dimë se shtimi i numrit të mësimdhënësve çdoherë e më shumë po bëhet problem në Komunën e Prishtinës.

**Mejreme Berisha** u pajtua me diskutimet e parafolësve, duke e kuptuar realitetin, sfidat që janë dhe problemet e shumta. Kemi një rini të mrekullueshme, një gjeneratë të shkëlqyer dhe unë mbase edhe i kuptoj ata që punojnë në fakultete. Ne jemi ata që i përcjellim prej shkollave të mesme dhe prej shkollave fillore, andaj unë shumë besoj dhe shpresoj se këto sfida, me një punë në të madhe më të ngritur, me një nivel më të lartë, jam e sigurt që nxënësit tanë do të kenë sukses jo vetëm në Kosovë, po edhe jashtë saj.

Lidhur me vërejtjet dhe sugjerimet e dhëna që u paraqitën nga parafolësit, sqarime shtesë dha **Halim Halimi**.

**U konstatua se u përkrah informata për suksesin e nxënësve në arsimin fillor dhe të mesëm të Komunës së Prishtinës, për vitin shkollor 2012/2013.**

**Pika e tetë dhe e nëntë**

**Pyetje, përgjigje dhe të ndryshme**

**Kryesuesi** edhe kësaj radhe kërkoi nga drejtorët e drejtorive që z. Shemsi Veseli t'i kthehen përgjigjet për pyetjet e parashtruara.

*Mbledhja përfundoi në orën 14:30*

**Procesmbajtësi**  
**Zijadin Gashi**

**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Sami Hamiti, ecc. i dipl.**